



1003/4
13.12.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E MBIKQYRJES SË TREGJEVE TË
SHËRBIMIT/JOPRODHUESE

Nr. 459/prot.
2

Tiranë, më 7.12.2021

Lënda: Në lidhje me vendimin nr. 208, datë 08.10.2021 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”.

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu” nr. 1023
Tiranë

Me anë të shkresës tuaj nr. 1003 prot., datë 18.10.2021 (protokolluar pranë AK me nr. 459 prot., datë 20.10.2021), jemi njoftuar se me vendimin nr. 208, datë 08.10.2021, Bordi i ERE vendosi mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”.

Nga sa më sipër, arrijmë në përfundimin se kjo procedurë është në mbështetje të nenit 7, pika 1, 16 dhe 20, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 6, pika 3, 16, pika 18, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar dhe nenit 15 dhe 26, të Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 17.06.2016.

Nga vlerësimi i këtij vendimi konstatohet se kjo procedurë nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

